



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 21

Datë: 29. 05. 2017, ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Adnan Rrustemi, Eshref Vishi, Ercan Spat, Bajram Ljatifi.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC.

Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

Rendi i ditës

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 17, 18 dhe 19/2017*

2. Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor;

3. Aktivitetet e ZRPP-së

- *Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve.*

4. Raport i Këshillave të KQZ-së

- Këshilli Çështje Ligjore;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Memorandum Mirëkuptimit në mes të MASHT-it dhe KQZ-së;*

- Këshilli për Operacione Zgjedhore

-Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit për Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit

-Udhëzime për Menaxherët e Qendrave të Votimit në lidhje me qasjen

5. Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe përmbajtjes së fletëvotimeve dhe broshurës së kandidatëve të subjekteve politike

6. Raport nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik

7. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve Nr. 17, 18 dhe 19/2017

Valdete Daka: Përshendetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në mbledhjen e 21-të të KQZ-së. Sa I përket rëndit të ditës, unë kisha propozuar edhe një pikë tjetër. E, ajo është te aktivitetet e ZRPP-së. Është vendimi I ZAP-it, me të cilin është anuluar vendimi I KQZ-së për certifikimin e kandidatëve të koalicionit BSDAK SDA. Prandaj, ne duhet të vendosim përseri lidhur me certifikimin e këtyre kandidatëve, apo jo? Por, derisa të n`a i bjen drejtoresha edhe vendimin, sepse pa këtë vendim nuk mundemi me i certifikuar as broshurat e kandidatëve. Kush është për këtë rend dite, me një shtesë të kësaj pike? Faleminderit! Vazhdojmë me pikën e parë, shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjeve 17,18,19. A ka dikush vërejtje në këto procesverbale? Nëse jo, atëherë kush është pro miratimit të këtyre procesverbaleve? Faleminderit!

- Komisioni miratoi procesverbalet e këtyre mbledhjeve.

-Aktivitetet e Sekretariatit lidhur me procesin zgjedhor;

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër. Aktivitetet e sekretariatit lidhur me procesin zgjedhorë. Urdhëro, kryeshef!

Enis Halimi: Faleminderit! Sekretariati ka vijuar aktivitetin e vet, në drejtim të përmbushjes së detyrave dhe obligimeve që dalin, dhe me qëllim të realizimit të procesit zgjedhorë të 11 qershorit. Sipas ligjit për zgjedhjet e përgjithshme votimi jashtë kosovës, përsa i takon periudhës së aplikimit për regjistrim, ne, brenda kësaj periudhe kemi pranuar 20 252 aplikacione. Nga 23 382 aplikacione për regjistrim 3892 zarfe përmes postes, d.m.th postar të komisionit, 253 aplikacione përmes faksit, dhe 19 237 aplikacione të pranuar përmes email-it. Nga 17 529 aplikacione që janë aprovuar përgjatë vlerësimit të kriterëve të zotësisë juridike 2 721

aplikacione janë identifikuar që janë dërguar që më parë. Por, pikërisht këtu qëndron edhe shpjegimi lidhur me këtë paradoksin që në shikim të parë duket numri 20 000 dhe 23 000. Numri i aplikacioneve të aprovuara është 14 956. Të refuzuara 14 aplikacione, për shkak që janë dërguar nga persona që janë nën moshën 18 vjeçare. 118 aplikacione për regjistrim që nuk kanë qenë të nënshkruara, si të tillë janë refuzuara. 5 164 aplikacione janë refuzuar për shkak që aplikuesit nuk kanë deshmuar kreiteret e zotësisë juridike. Poashtu, meqë e kemi pikë të veçantë të rendit të ditës, pas hedhjes së shortit është bërë edhe dizajnimi i fletëvotimeve dhe broshurave, pas miratimit. Sa i takon dimensioneve të tjera i kemi të paraqitura edhe kontratat, përkatësisht statusin e këtyre kontratave për funizim me material zgjedhorë. Pra, disa kontrata janë ende në procedurë, disa janë të përfunduara dhe presim lehtësimin e materialeve adekuate për mbajtjen e zjedhjeve të 11 qershorit. Edhe në branshat tjera aktiviteti po vazhdon vijueshem. Kishim me përmend që deri me tani 18 komuna i kanë sjellë nominimet e tyre për këshillat e vendvotimeve dhe është një proces që po zhvillohet në vazhdimësi. Besoj që ditët e ardhshme, nesër pasnesër do t'i procedojmë për miratim. Faleminderit!

Valdete Daka: Faleminderit, kryeshef! A ka dikush pyetje? Po, urdhëro Ercan!

Ercan Spat: Faleminderit, kryetare! Faleminderit edhe kryeshefit për raportimin e rregulltë të cilin po na përgatitë para çdo mbledhje. Unë kam një pyetje për kryeshefin. Deshta me pyet, se para katër dite unë inicova një çështje, në pikën të ndryshme. Një rast të disa ankesave për caktimin e vendvotimit për një lagje në qytetin e Prizrenit. Deri sot, edhe pse ishte fjala për, edhe e ka marrë kryeshefi atë ditë obligim sa më shpejtë me na informuar lidhur me çështjen, deri sot nuk kemi asnjë informatë. Nëse ka informatë le të na informon.

Valdete Daka: Urdhëro!

Enis Halimi: Faleminderit! Përsa i takon pyetjes së parë, ne e kemi marrë me shumë seriozitet shqetësimin e ngritur nga zotëri Shpat dhe kemi diskutuar edhe me zyrtarin komunal dhe me shërbimin votues që bën alokomin e votuesve nëpër qendrat e votimit. Por, problem me listen e votuesve, përkatësisht me alokimin e sakt të votuesve nëpër qendrat e votimit nuk është problem i ri, dhe është një problem me të cilin në jemi ballafaquar edhe në të kaluarën, dhe ndoshta nuk kemi mundur që të japim zgjidhje në mënyrën më të mirë të mundshme, për shkak të shumë faktorëve. Por, megjithatë për rastin konkret, vendbanimi për të cilin ju i referoheni, pra një lagje në Prizren. Nuk është vendbanim zyrtarë i regjistruar në regjistrin qendroë civil, dhe identifikimi i votuesve mbi këtë bazë, pra duke pas për bazë regjistrin civil është i pamundur. Ne kemi marrë masat adekuate, dhe në konsulltim me shërbimin përkatës edhe me zyrtarin komunal atje i kemi bërë caktimin e votuesve. Pra, e kemi kthyer gjëndjen konform masave që kanë qenë në vitin 2014 dhe besoj që tashmë këto probleme janë të tejkaluara. Unë i kam këto raporte. Për sa i takon pyetjes së dytë të ngritur nga z. Rikallo. I kam këto raporte, dhe kam raportu besnikrisht, në përputhje me atë që më është dhënë nga shërbimi profesional. Koha kur është raportuar ka qenë, është prerë koha, dhe në atë moment ato kanë qenë shifrat që janë dhënë nga shërbimi dhe pastaj, ndoshta është rritë intensiteti i punës, dhe është një muner i tillë i

aplikacioneve. Unë u siguroj që nuk ka asnjë aplikacion, për aq sa mund të garantohet, që është pranuar jashtë rregullatve ligjore, jashtë afateve përkatëse të dakorduara këtu. Sikundër edhe ju e thatë, ka edhe shumë aplikacione të dyfishta, të ashtuquajtura duplikate. Dhe, edhe njëherë t`a rikujtojmë që Brenda një aplikacioni, përkatësiht brenda një emaili, dhe ju sikundër e patë në raport, shumica e aplikacioneve kanë ardhur permes emailit. Sikur jemi dakorduar, në një email mund të ketë më shumë se një aplikues, dhe këto janë shkaqet që kanë sjellë që të kemi një paraqitje më të madhe tash.Edhe atëherë ka qenë gjendja reale. Konstatuesi aktual i aplikacioneve të caktuara është paraqitur në raport këtu. Faleminderit!

Valdete Daka: Faleminderit kryeshef. A ka dikush ndonjë pyetje tjetër? Nëse jo vazhdojmë me pikën tjetër, ajo është Aktivitetet e ZRBP-së. Së pari e kemi akreditimin e vëzhguesëve.

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve

Miradije Mavriqi: Faleminderit kryetare, zyrja ka përgaditur rekomandim për akreditimin e vëzhguesëve duke u bazuar në nenin 54.1 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, nenin 3 të rregullës zgjedhore 07 2013, nenin 3.1 paragrafi 8 i rregullës zgjedhore 15 2013 për zgjedhje të jashtëzakonshme dhe zgjedhje të parakohëshme si dhe planit operacional të KQZ-së për zgjedhje të parakoëshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 11 qershor të këtij viti. Deri me 26 maj janë procesuar aplikacionet e vëzhguesëve të një organizate ndërkombëtare megjithëse 23 vëzhgues.Të gjitha kushtet janë plotësuar, dhe zyrja rekomandon të akriditohen vezhguesit e organizatës ndërkombëtare EUEOM me gjithësej 23 vëzhgues.Faleminderit!Këtu e keni edhe listën e bashkangjitur me emrat e atyre vëzhguesëve të asaj organizate ndërkombëtare.

Betim Gjoshi: kryetare, unë e falenderoj BE-në, që ka sjellë kaq heret vëzhgues. Sipas diskutimeve që kemi pas, për me bë të qartë flitet për misionin e vëzhguesve të BE-së

Valdete Daka: Po? A ka diçka tjetër?

Adnan Rrustemi: E kuptoj që zyra e ka të pamundur me n`a informuar, por unë e vlerësoj që është I rëndësishem roli I vëzhguesve të BE-së. shpresoj që nuk është numri përfundimtarë.

Valdete Daka: Jo, nuk është. Ata do të vijnë në disa etapa. Këta janë vëzhguesit e parë që kanë ardhur dhe e vëzhgojnë procesin që nga ky moment. Ndërkaq ata të tjerët do të jenë që do të vëzhgojnë vetëm ditën e zgjedhjeve dhe pas zgjedhjeve. Kush është për akeeditimin e këtyre votuesve?

Komisioni miratoi këtë pikë të rendit të ditës

Valdete Daka: Faleminderit! Vazhdojmë me pikën tjetër.Ajo është vendimi I PZAP-it. E keni para jush vendimin e PZAP-it, me të cilin është aprovuar apeli i koalicionit SDA-BSDAK, dhe

është anuluar vendimi i KQZ-së i datës 24 maj. Ndërsa çështja i është kthyer KQZ-së në rishqyrtim dhe rivendosje. Kemi të bëjmë me listen e kandidatëve, pra me çertifikimin e kandidatëve. KQZ-së i është sugjeruar që, sipas vendimit të cilin ekeni para jush, është sugjeruar që KQZ duhet që, nëse zyra ka deshtuar që ta njoftoj subjektin politik lidhur me korigjimin e listave atëherë këtë ka mundur vetëm KQZ-ja ta bëjë. Pra nuk ka mundur zyra të i hjekë nga lista e kandidatëve disa persona, por këtë ka mundur të a bëjë KQZ-ja. Po!

Betim Gjoshi: Faleminderit! Mendoj që, pa dashtë me vlersuar vendimin e PZAP-it, ata brenda kompetencave të veta kanë vendosur. Por, mendoj që munda I punës së KQZ-së nuk po shkon deri në fund. Thuhet që ne nuk e kemi njoftuar kandidatët. Nëse nuk i kemi njoftuar, atëherë një pjesë e shërbimit tonë ka deshtuar, sepse ne një ditë me parë kemi marrë vendim, dhe kemi dhënë një afat 24 orë që të bëhet korigjimi në listë. Nëse zyra nuk e ka bërë këtë me shkrim, atëherë është një lëshim i saj procedural, sepse mendoj që komunikimi duhet të bëhet me shkrim, pasi kështu është edhe mënyra më e mirë që ruhen dëshmitë. Ne e kemi marrë një qendrim dhe kemi pritë 24 orë për përmisim. Në bazë të atij qendrimi, dhe kemi vendosë. Zyra mundet me në a treguar, pasi arsyeja kryesore që është marrë ky vendim, në bazë të tekstit që po shkruhet është që ne nuk i kemi dhënë afat procedural për përmisim. A e ka njoftuar me shkrim subjektin për me bërë përmisimin, a jo? Kjo është e rëndësishme. Sepse, ne qysh i a kemi dhënë afatin 24 orë. Ne i kemi procesverbalet dhe mundemi me I kontrollu. Jane dokumente që shihen.

Bajram Ljatifi: Për me qartësuar, ne kemi marrë vendim që subjekti politik çertifikohet dhe kemi kërkuar 24 orë që të në a jepet shpjegim për kandidatët. Komunikimi ynë mes zyrës dhe këtij subjekti politik, ka qënë me shkrim, apo në çfar forme?

Miradije Mavriqi: Faleminderit! Fillimisht, kur është marrë vendim prej KQZ-së që të çertifikohen vetëm subjektet politike pa kandidatët e tyre dhe i u dha 24 orë afat. Ne i kemi ftuar kryetarët e këtyre subjekteve politike, konkretisht e kemi ftuar kryetarin e këtij koalicioni për përmisim të listës së kandidatëve. Sepse, në bazë të një ankese ka pas dyshime që janë të komunitetit shumicë disa kandidat nëpër parti tjera politike. Mirpo, ne paraprakisht kemi dërguar edhe një shkresë zyrtare agjensionit për regjistër civil, i cili në a ka kthyer shkresën dhe i ka gjetur në listat e këtij subjekti politik që 4 kandidat të tyre janë të regjistruar si shqiptarë. Në baze të kësaj, ne atëherë i kemi thirrë edhe kandidatët e tjerë, të cilët janë deklaruar 6 prej tyre. 6 kandidat të këtij subjekti politik vet janë deklaruar që i takojnë komunitetit shqiptarë. Kështu që gjithsej janë 10. Dhe, ne pastaj kemi rekomanduar KQZ-në që këta 10 të largohen dhe të çertifikohen 20 kandidat të këtij subjekti politik. Kjo ka qënë mënyra e komunikimit.

Valdete Daka: Faleminderit! Po, urdhëro!

Adnan Rrustemi: Faleminderit! Është e vërtetë që ne e morem në çastin e fundit këtë vendim nga PZAP-i. Megjithatë ngjarja e ka një histori procedurale. Ne e dimë që në mbledhjen kur i kemi çertifikuar subjektet politike dhe kandidatët, veçmas të partive shqiptare rekomandimi i ZRPP-së i ka përfshirë të gjitha subjektet që kanë paraqitë kërkesë për të u çertifikuar bashkë me

kandidatët e tyre, dhe në bazë të nenit 29 ku flet për përshtatshmerinë e kandidatëve, rekomandimi i zyrës ka qënë që të gjithë kandidatët të gjitha subjekteve politike janë në përputhje me ligjin. Në ndërkohë u paraqit kjo çështja e etnicitetit të kandidatëve. Siç e kam thënë edhe në mbledhjet e kaluara nuk mendoj që është në përgjegjësi të KQZ-së për t'a verifikuar këtë aspekt për sa kohë që nuk është kërkesë e ligjit mbi zgjedhjet, sidomos të nenit 29 ku flet për përshtatshmerinë e kandidatëve. Megjithkëtë, çështja ka kërkuar një interpretim ligjorë dhe kushtetues më adekuat që ne nuk e kemi pasur në dispozicion kur bëhet fjalë për interpretimin e vendeve të rezervuara unë siq kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar më e rregullt ka qënë se KQZ sot e ka mundësin me kompenzu këtë devijim po e quaj që ne të qertifikojmë listën me rekomandimin e ZRPP-së ndërsa palët tjera të cilat e konisderojnë se I cenohet të drejtat në përputhje me nenin ta apelojnë vendimin e KQZ-së në pzap dhe të vërtetohet nga pzap si trup edhe e përbërë nga gjyqtarët apo i instancave të tjera që në këtë rast qertifikimi ka qënë I pabazuar. Unë serish propozoj që ne në fakt ta miratojmë rekomandimin e zyrës të mbledhjes së parë nuk e mbaj në mend datën dhe pastaj të vërtetohët që lista në fjalë nuk është në përputhje ose me kushtetutën në këtë rast, sepse është e diskutueshme siq e kam thënë se deri ku ne mundemi me shku me verifiku këtë aspekt të kandidatëve individual, unë pajtohem që subjektet politike që janë në këtë rastë subjekte elektorale që i nënshtrohen qertifikimit duhet të percaktohen se a garojnë për vendet e rezervuara apo jo, dhe mendojë që në këtë faz, në këtë pik kemi qënë mirë edhe në përputhje me ligjin ndërsa kur bëhet fjalë për individët, në këtë rast duhet ta kemi edhe parasyshtë aspektin që ne mund të cenojmë të drejta kushtetuese, të drejta themelore të njeriut për angazhim të lirë edhe politik, por edhe tjetër. Faleminderit.

Sami Hamiti:Faleminderit, kryetare! Pak specifike edhe vendimi I pzapit me thon të drejtën edhe esenca thotë që nuk janë njoftuar me kohë, është një element, edhe a kanë të drejtën ata si komunitet shumicë apo edhe si shumicë të jenë në listën e pakicave është krejt element tjetër, dmth nese kthehet një vendim pse, nuk janë njoftuar me kohë edhe me shkrim dhe nuk është zënë afati, ata duhet të kthehen brenda në listë është krejt çështje tjetër. Nëse ato vendet e garantuara janë specifikisht të përcaktuara me kushtetutë që i'u takojnë pakicave është një element qëduhet të jenë listat e pakicave. Më qesharake është ajo listë të cilën unë kam parë që ata kanë marrëveshje me kandidatët që janë të shumicës, që për mu është joetike, jomorale që ata kane hyrë në atë listë. Por, që të tërhiqen në momentin që të marrin votat dhe të mbesin deputetet të pakicave. Është në farsë, element mashtrimi. PZAP-I e ka marrë ate vendi. Unë nuk do t'a votoj vendimin e PZAP-it.

Valdete Daka: Ne n`a është lënë një mundësi, e ajo është që vendimi i cili është kthyer të rivendoset. Pra është anuluar vendimi për aryse procedurale, jo për çështje thelbësore, sepse këtu nuk është shqyrtuar fare ajo a kanë ata të drejtë me qënë në listë a jo?! Por, vetëm për çështje procedurale, ajo është që ne nuk kemi njoftuar me kohë. Tash ky afat nuk mund të mirret parasyshtë fare, që ata të njoftohen me kohë, sepse tash ky subjekt e din që këta kandidatë nuk mundën me qënë në listë, por ne mundëmi përsëri me vendosë për qertifikim apo jo të tyre. Urdhëro!

Betim Gjoshi: Mendoj që ne është mirë me nxjerrë mësim. Nuk mendoj që kemi qenë në rregull. Nuk mendoj, nëse e ka nënshkruar përfaqësuesi i partisë një listë të pastruar dhe nuk arritë me t`a pastruar tekstin. E kanë nënshkruar me kimik mbi të. Është çështje e joseriozitetit tonë. Janë dy elemente procedurale. E para, që nuk kemi me shkrim që kemi njoftuar. Që zyra nuk na dha përgjegje prap, a i ka dërguar shkresë, a jo?! E dyta është kjo, që kur e kanë nënshkruar e kanë bërë korigjimin ata, personi kontaktues i tyre ka nënshkruar mbi listë e cila ka qenë e pastruar me kimik, e nuk i`u ka pastruar kjo listë me kompjuter. Unë e di që ka qenë punë stresi. Por, ne sot duhet me pas një rekomandim të çartë prej zyes, për cilët kandidat po votojmë me i çertifikuar, cilët jo?! Duhet me dhanë sqarimin e qartë, jo me thënë në baze të ankesave, si e ka bërë në arsyetim, por në bazë të nenit 111 të ligjit për zgjedhje ky subjekt ka garuar për vende të garantuara dhe 10 kandidat nuk i përkasin asaj etnie për të cilën kanë garuar. E kemi deshminë e tyre personale, deshminë e agjensionit të regjistrimit civil. KQZ i ka dhënë 24 orë afat me i korigjuar, kanë qenë të njoftuar, kanë qenë në takim me datën kaq. Të gjitha këto duhet me i futë në arsyetim. Në këtë mënyrë ne mundemi me i çertifikuar të njejtë kandidat që kanë qenë. Duhet me pajisë vendimin me arsyeime, sepse jo si mungesë e shkruarjes së vendimeve ne me n`a u kthyer vendimet. Unë pajtohem me Saminë, nuk është kthyer vendimi për shkak që ne i`a kemi shkelur të drejtën dikuj, sepse është e kundërta nëse veprojmë. Por, për shkak të procedurave jo të sakta që po i ndjekim.

Bajram Ljatifi: Kryetare, atë ditë që I kemi çertifikuar kandidatët e këtij subjekti 4 orë jemi vonuar pikërisht për këtë subjekt. Prezencën fizike të tyre e kemi pasë në zyrat tona, dhe unë dhe një pjesë e antarëve kemi qenë të informuar me komplet çka po ndodhë. Janë njoftuar komplet me telefon dhe e kanë nënshkruar listen se kush do të jenë kandidat në listen e tyre. Është nënshkruar nga zyrtari përgjegjës i subjektit politik. Këta persona të cilët janë të komunitetit shqiptarë dhe nuk do të dojnë të jenë pjesë e kësaj liste, është e nënshkruar prej përfaqësuesit të subjektit politik. Nëse janë evidente shkeljet procedural janë të qarta qendrimet që këta kandidat nuk bën me qenë të çertifikuar me u bë pjesë e këtyre zgjedhjeve. Sepse e ke nënshkrimin e përfaqësuesit të këtij subjekti politik s`e ata kanë pranuar të gjithë që të mos jenë pjesë e listës.

Adnan Rrustemi: Në aspektin procedural ne e kemi një rekomandim ZRPP-së. Madje të protokoluar dhe të paraqitur është ne ditën kur i kemi mbajtë te gjitha subjektet e të gjithë kandidatet KQZ e ka mundësin me vendos për kundër rekomandimit të ZRPPS. Unë mendoj që ligjërisht proceduralisht pa u lëshu ne përmbatje nuk duhet me ndryshu rekomandimin të ZRPP-së se këtu madje futemi në një qark tjetër të shkeljeve të mbrendshme. ZRPP-ja e ka sjellur rekomandimin, mirë e keq është çështje tjetër që e mbanë përgjegjësinë që i`u ka referuar dispozitave të ligjit. Tash KQZ-ja mundet me miratuar rekomandimin e ZRPP-së të plotë mundet me miratë të pjesshëm ose të hidhet krejt poshtë për rastin konkret. Por nuk mendoj që është mirë t`i kërkohet rekomandim tjetër se krijojmë situatë të re...

Valdete Daka: At`here, që ti shkurtë mundimet ne e kemi një listë këtu e cila tash pavarësisht krejt kësaj a kan marr njoftim apo nuk kan marr e kemi një listë të cillën e kanë dorëzuar ata me 30 emra, e kemi edhe një listë ku ne k`jart e dimë cilët emra janë shqiptarë cilët

janë të etnitetit tjetër sepse edhe e jani deklaruar vetë e kanë pranuar që kanë hyrë në listë vetëm për të garuar si shqiptarë me marrë vota dhe pastaj me ja leshu vendin minoritetit, ndërkaq e kemi edhe listën e saktë e cila tregon se cilët janë ata kandidatë të cilët i takojnë etnitetit boshnjakë apo cilitdo qoftë nuk është me rëndësi edhe atëherë e kemi shumë të qartë që të mos ta kthejmë përsëri në zyre se ne më edhe fizikisht nuk kemi afat, na duhet sot edhe me miratu.

Betim Gjoshi: A bën kryetare? Po le të mbajnë shënim qa me shënu zyra, dmth në arsyetim të vendimit edhe drejtori I zyrës ligjore duhet të jenë, që ne po ju kemi dhënë 24 orë afat më të gjatë se krejt subjekteve politike që e kanë pranuar me ardhë por, për shkak të presionit në kohë në ora 10 te natës ose 9 sa ka qenë kemi përmirsuar listën të cilën e kanë nënshkruar ata, e dyta , e treta që kemi kontakti institucionet përkatëse me marr informacione, e katërta , vullnetin që e kanë shprehë vetë personat që kanë deklaruar për tërheqje dmth këto duhet ti përmbajë rekomandimi në qoftëse e marrim me 20 edhe duhet të jetë lista e pastruar bashkangjitur kësaj edhe 5 se dmth qdo vendim tjetër do ti rrezikonte sot sepse janë miratuar broshurat edhe fletëvotimet se veq I kemi tutje.

Valdete Daka: A deshte diqka?

Bajram Ljatifi: Po kryetare. Mua nuk më duket në rregull nëse një vendim I PZAP-it vjenë drejtëpërdrejt në takimin e Komisionit Qëndrorë të Zgjedhjeve menjëherë të mirret me procesin e shqytrimit dhe riprocedimit të rastit ashtu siq kërkon pzapi. Unë do të kisha kërkuar që megjithëatë zyra për regjistrimin e partive politike duhet të mirret me rastin konkret dhe të raptoj para Komisionit Qëndrorë Zgjedhorë njëhkosishtë edhe duhet të mirret me vendimit e pzapit në mënyrë që të sjellë rekomandimin se qfarë duhet të veprojmë ne.

Valdete Daka: Ne fakt, ky vendim tashmë është I KQZ-së nuk është I zyrës, është anuluar vendimi I KQZ-se prandaj ju ka sjellë KQZ-së në rivendosje, nuk ka qenë vendim I ZRPP-së por, ka qenë vendim I KQZ-së.

Adnan Rustemi: Po po është mbi vendimin e KQZ-së por, siuate kthehet në pikën zero, ose, se në I kemi dy mundësi ose me ankimi KQZ-ja këtë vendim, po dua të them proceduralisht nëse e ka konstatuar procesin e vendimmarrjes si të gabueshme, kjo kthehet në pikën fillestare, edhe mendoj se ZRPP-ja po unë nuk mendoj që pajtona me Estrefin që na nuk mundemi me trajtu mbi bazën e tabelave ku ka plus minus, një fletë nëëord duhet lighërisht, proceduralisht është dashur të ketë një rekomandim të ZRPP-së dhe që mendoj që duhet me qenë rekomandimi I parë, e mbi bazën e këtyre rekomandimeve KQZ-ja vendosë ndryshe, ose nuk e di ne qka po vendosim sot, këtu nuk po kuptoj mbi qfarë material po vendosim, në të njejtën mënyrë jemi duke vendosur si në mbledhjen e fundit vendimin të cilin e ka rrëzuar PZAP-i.

Betim Gjoshi: Kalojmë në pikat e tjera të ditës, e bëjmë një mbledhje në ora 5 përgaditet zyra.

Valdete Daka: Nuk mundemi me aprovu fletëvotimin, fletëvotimin po por, broshurat jo. Vazhdonmë me raportin e këshillave.

Betim Gjoshi : Kryetare mendojë që edhe broshurat, dizajnin me kusht që kjo mundë të përmirsohen varësisht prej vendimit përfundimtarë deri sot.

Kjo pikë e rendit të ditës u kalua pa miratim.

- Shqyrtimi dhe miratimi i Memorandum Mirëkuptimit në mes të MASHT-it dhe KOZ-së;

Valdete Daka: Raporti I këshillave të KQZ-së, Këshilli për Qështje Ligjore .Urdhëro.

Sami Hamiti: Faleminderit Kryetare. Në mbledhjen e sotme të Këshillit për Qështje Ligjore kemi shqyrtuar memorandumin e mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Teknologjisë dhe Komisionit Qëndrorë të Zgjedhjeve dhe me një ndërhyrje në nenin 3 pika 2 me konsensus anëtarët e këshillit e kemi propozuar që të vjen në KQZ dhe të aprovohet.

Valdete Daka: Faleminderit, atëherë a ka dikush diqka. Kush është për nënshkrimin e këtij memorandumin.Fleminderit.A ka kundër. Jo.

Komisioni miratoi këtë pikë të rendit të ditës

Shqyrtimi dhe miratimi i Udhëzimit për Anëtarët e Këshillave të Vendotimit

Adnan Rrustemi:Këshilli operacioneve zgjedhore ka shqyrtuar tri pika për mbledhjen e sotme, pika e parështë Udhëzimi për antarët e këshillave të vendotimeve në këtë rast është një udhëzim i përgatitur në cilësi të informacionit që ka të bëjë me një rolë pozitiv do të thoja unë dhe poashtu në përputhje me ligjin që duhet ta luajn të gjithë antarët e këshillave të venëvotimeve në raport me votuesit me aftësi të kufizuara do të thoja, e gjith idea është që të përmbledhet një list e veprimeve te secillit komisioner në raport me votuesit që paraqiten, nga ajo që si duhet të i`u ofrojnë ndihmë e ti ndihmojn në gjetjen e vendvotimit e deri tek mënyra e votimit gjithmonë në përputhje me ligjin pa cënuar asnjë aspekt. Po ashtu edhe për votuesit e verbër që përdorin fletëvotimin në braid të sigurohemi që komisionerët janë në dijeni ku ndodhen shabllonet dhe ti ofrohen në shërbim gjithë votuesve. Ne pas disa ndryshimeve që i kemi bërë në këshill materialin si të tillë, rekomandojmë KQZ-në që ta miratoj dhe ky informacion ose udhëzim ti shpërndahet këshillave të vendotimeve para ditëve të zgjedhjeve.

Valdete Daka: Faleminderit, kushështë për këtë udhëzim? Faleminderit, vazhdojmë me pikën tjetër.

Komisioni miratoi këtë pikë të rendit të ditës pa kundërshtime

Udhëzime për Menaxherët e Oendrave të Votimit në lidhje me qasjen

Adnan Rrustemi: Udhëzimi i dytë ka të bëj me trupat e administrimit të zgjedhjeve nga KKZ-të menagjerët dhe antarët e këshillit të vendëvotimeve në aspektin se si duhet të organizohet dhe të funksionoj njëqendër e votimit me ças`shmërin për personat me aftësi të kufizuara sërish. E gjithë idea është që të shmangen disa nga pengesat që diku ka qënë përgjegjësi e menagjerëve të vendëvotimeve apo të komisionerëve diku edhe munges informacioni që qendrat të organizohen dhe vendëvotimet në atë mënyr që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje të lehtësuara dhe të siguruara për të votuar individualisht nga ajo që pjerrinat e vendëvotimit nuk duhet mbyllet me qfar do pengese me shirita apo tjetër siç ka ndodhur në disa raste deri tek ajo se kudo që është e mundur me siguru pjerrina të përkohëshme vendosjen e vendëvotimeve në qendrat e votimit që ka numër të vogël të vendëvotimeve, të gjitha në katin e parë që mos të jetë nevoja të ngjiten në katin e dytë dhe vendosjen e vendvotimeve të dyfishta poashtu në katin e parë që votuesit me nevoja të veçanta, në këtë rast me aftësi të kufizuara të mos kenë pengesa të tilla, por edhe organizimi I vendvotimeve në raste specifike, siç është kabina ose kutia me u vendosë në dimensione të përshtatshme që votuesit me pas mundësi me votuar edhe nga karrocet e tyre. Në e rekomandojmë KQZ-në që të miratohet si em tillë dhe të shpërndahet të gjitha trupave në nivel lokal.

Valdete Daka: Faleminderit! Atëherë, kush është për?

Komisioni miratoi këtë pikë të rendit të ditës.

-Shqyrtimi dhe miratimi i dizajnit dhe përmbajtjes së fletëvotimeve dhe broshurës së kandidatëve të subjekteve politike

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën tjetër. Ajo është, shqyrtimi dhe miratimi I dizajnit dhe përmbajtjes së fletëvotimeve dhe broshures së kandidatëve të subjekteve politike. Po, urdhero kryeshef!

Enis Halimi: Faleminderit, kryetare! Para jush është dizajni I fletëvotimeve dhe I listave të kandidatëve apo broshura. Konform planit operacional sekretariati ka bërë dizajnimin e këtij fletëvotimi për zgjedhjet e parakohëshme për kuvendin e Kosovës. Dizajni, përmbajtja dhe formati I përmbushë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara me nenin 87 që flet për përshkrimin e fletëvotimeve dhe materialit në lidhje me fletëvotimin, përkatësisht nenit 87 pika 1, pika 5 dhe pika 8 të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Fletëvotimi përmbanë llogon, organin publik që do të zgjidhet, tekstin udhëzues shenoni vetëm një, tekstin udhëzues shenoni më së shumti 5 kandidat, emrin, numrin, llogon dhe hapsirat për shenim të subjekteve politike në anën e majtë, hapsirat e numrave në anën e djathtë, ngjyrat e kornizës së fletëvotimit është e kuqë, ndërsa ngjyra e tekstit në brendi është e zezë, teksti në fletëvotim është në gjuhët zyrtare, në dy versione pra, në gjuhën shqipe dhe serbe në gjitha komunat, përveç në disa komuna sikundër janë

Prishtina, Gjilani, Prizreni, Vushtria, Mitrovica dhe Mamusha ku teksti është më tri gjuhë. Pra, shqip, serbisht dhe turqisht.pra, conform rregullatives që rregullon këto çështje. Të bashkangjitur e keni edhe mostren se si do të duket fletëvotimi, dhe poashtu edhe listat e kandidatëve. Si të tilla janë të gatshme për miratim. Faleminderit!

Valdete Daka: Faleminderit! E keni para jush mostren e fletëvotimit. Urdhëro, Ercan!

Ercan Spat: Është një çështje krejt teknike. Me një shkronjë të alfabetit në gjuhen turke. Shkronja I e madhe kur e ka pikën po mungon në disa vende.Le të përmisohet.

Valdete Daka: këtë herë është një risi. Ajo është që hapsira është e ndarë, e kufizuar në mënyrë të barabartë për secilin subjekt. Ky është mostra e fletëvotimit dhe mund t`a hedhim në votim. Kush është për këtë dizajn? Faleminderit! Po?

Bajram Ljatifi:Kreytare, kërkoj prej sekretariatit që menjëherë të publikohet në uebfaqëe të KQZ-së fletëvotimi dhe broshura, në mënyrë që ata njerëz që e kanë gjetur veten në listen votuese nga diaspora shqiptare, mundet menjëherë ta shfryëzojnë të drejten, dhe të votojnë, sepse nëse I përmbahemi rregullatives që e kemi, atëherë shumë problem që do mundemi me kohë të n`a vijnë fletëvotimet si është e paraparë me plan operacional. Kështuqë menjëherë të publikohet në uebfaqe të KQZ-së dhe kush do mundet t`a ketë.

Valdete Daka: Në fakt e kemi vetëm një problem të vogel. Nuk mundemi me publikuar pa vendosur për numrin 34 për këtë koalicionin. Fletëvotimin po, por është e pajustificueshme me e publikuar fletëvotimin pa kandidat.

Adnan Rrustemi: Është e mundur me I publikuar pa subjektin e fundit, sepse ky nuk është document ligjorë. Edhe, në ndërkohë kur plotësohet zevendësohet me automatizem.Nuk ka ndonjë problem.Në rrefull është ajo, por le të bëhët gati. Mendoj që faza e dytë, le të shfrytëzohen kapacitetet që procesi I votimit të jetë sa më efikas. Të mos kemi pengesa teknike. Madje le të shrytëzohen edhe të dhënat e votuesve që janë emaila, që të informohen për këtë periudhë për dokumentet , për kushtet , për procedur. Na sot e kemi shqyrtuar edhe materialin e informimit publik që Iliri do të raportojë me siguri që po bohet një punë në drejtimë të informimit të votuesve se si duhet të votohet dhe si duhet të dërgohet fletëvotimi.

Valdete Daka: Atëhere kush është për këtë broshurë sepse edhe këtë duhet të votojmë pa këtë numërin 34 .Faleminderit!

Komisoni miratoi këtë pikë të rendit të ditës

6. Raport nga Këshilli Mbikëqyrës për Informim Publik

Valdete Daka: A vazhdojmë me pikën tjetër? Ajo është raporti nga Këshilli mbikqyrës për informim publik.

Bajram Ljatifi:Faleminderit kryetare , në faktë na si këshill mbikqyrës për informim publik kemi trajtuar shumë qështje edhe kemi mbajtë 3 takime të fundit duke përfshirë edhe sot dhe kemi trajtuar dhe kemi miratuar shumë operacione rreth saj , natyrisht që duke pasur parasysh dhe kohën e shkurt të cilën e kemi , se kanë fillu të transmetohen edhe shumë në tvspotet ku kompania ka fillu që të transmetojë në radio dhe në televizione nacionale edhe të tjerë , kemi miratu siq e keni pa tingullin I cili do të përdoret për të gjitha TV dhe radio spotet , sloganin , dizajnin për banera që duhet të vendosen në portalet e lajmeve dhe gjithashtu për të mos hyrë të gjitha veq e veq me I trajtu sepse edhe raportin e keni para vetës , kemi bërë njoftimet nëpër gazeta që kanë fillu të publikohen që nga data 27 maj që janë shpërndarë poster nëpër komuna ku janë themeluar edhe qendrat e reja, sa I përket qendrave të reja të votimit, fletushkat për 3 fazat në 38 komuna, kurse në takimin e sotëm kemi shqyrtuar dhe I kemi miratuar që në TV dhe radio spotin si të votohet në AVPP-të në të dy gjuhët, mediaplanin për transmetimin e TV spotit si të votohet dmth AVPP-te në KTV dhe TV21, shqyrtimi dhe miratimi I skenarit për TV dhe radio spotin motivues për të rinjët , dizajnin për poster dhe fletushkat, si të plotësohet fletëvotimi, dizajnin për poster dhe fletushka për hapat në vendëvotim , njoftimin dhe dizajnin për billboard si dhe qeshtjet tjera të rëndësishme të cilat janë të përfshira të gjitha në raportin të cilin ju e keni par avetës. Po mendoj se jemi duke shkuar me dinamikën e paraparë duke e marrë në konsideratë natyrisht edhe kohën e paraparë, faleminderit.

Valdete Daka: Po urdhëro.

Bajram Ljatifi: Kërektoj falje që po ju pyes, por, pasi ne jemi një pjesë e anëtarëve që nuk jemi pjesë e Këshillit, kishim mujt me pas një media planë të këshillit me pa se cilat janë mediumet ku ne si institucion jemi prezent, pra mundemi mi pa produktet tona qoftë me zë qoftë këtu qka u thanë, vetëm me pas me vretjtë sa jemi prezent edhe sa I përmbahemi minutarër dhe se sa herë do të jemi prezent në këto mediumet që I thatë ju dmth kisha kërkuar që edhe anëtarët tjerë që nuk janë pjesë e këshillit ta kenë një mediaplanë ku ta dimë sakt kur, qysh, si I përfaqësojmë me sa minuta edhe me krejt këto qka I thatë ju. Po kryetare është qeshtje procedurale e sekretariatit që do tia përcjellë dhe anëtarëve të tjerë mediaplanin të cilin veq është I gatshëm, edhe produktet natyrisht të cilat po trjatohen.

Valdete Daka: Faleminderit, unë veq ju kisha thënë që të mos largohemi nga KQZ-ja sepse në afat sa më të shkurtër do ta vazhdojmë mbledhjen.

Betim Gjoshi:Ne këta që i kemi në kompetencë ti dicitlojmë nuk po mundemi, e po mundet ZAP-i.

Valdete Daka:Jo ne ti dicitlojmë jo... Urdhëro drejtoreshë.

Miradije Mavriqi: Faleminderit kryetare, zyra ka kontrolluar të gjithë dokumentacionin e subjektit politikë të koalicionit ESDA -BSDAK i cili fillimisht ka aplikuar me 30 kandidatë në listën e saj. Zyra i ka kontrolluar, kanë aplikuar konform legjislacionit, mirëpo me qëllim të zbatimit të vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 23 maj, përmes të cilit KQZ-ja ka marrur vendim që kandidatët të subjekteve politikë, përkatsisë etnike jo shqipëtare, që kanë aplikuar për çertifikim në zyrën për regjistrim të partive politike duhet të verifikohet përkatësia e tyre etnike dhe atënjepërmas agjensionit për Entin Statistikor dhe pasi agjensionii Statistikave të Kosovës në zyre e kanë kthyer përgjegjjen që nuk është kompetente për të dhënë të gjitha të dhënat e qytetarëve ose atyre që janë në statistikët cilët i mban në statistikë, atëherë zyra i është drejtuar Agjensisë për Regjistrim Civil që përgjegjjen ta kthejë sa më shpejtë konkretisht ti verifikojë këta kandidatë të cilët janë të komunitetit jo shumicë. Me datën 24 AVC-ja i ka kthyer përgjigje zyrës dhe e ka njoftuar se në listat e këtyre subjekteve politike gjenden 4 kandidatë që nuk i përkasin komunitetit boshnjak por i përkasin komunitetit shqiptarë. Zyra me këto të dhëna nga AVC-ja eka marrë listën e të njëjtit subjekt politik dhe i ka thirrur të gjithë kandidatët me telefon, 6 prej tyre janë deklaruar që i përkasin komunitetit shqiptarë dmth 4 prej AVC-je dhe 6 nga këta kandidatë vetë janë deklaruar njëkohësisht kanë ardhur dhe në zyrë, kanë ardhur kandidatë me kryetarë të artyre partive politike sepse ju ka interesuar dmth që kur i kemi thirrur ne që listën duhet ta perpilojnë dhe ta spastrojnë, ta dorëzojnë tëspastuar të nënshkruar atëherë në prezencën të dy kryetarëve në prezencën e dy kandidatëve të atyre subjekteve politike dhe në prezencën e zyrtarëve të zyrës është bërë dmth nënshkrimi i asaj liste ku dmth pajtohen që të hiqen edhe ata 6 kandidatë tjerë të cilët janë deklaruar që i takojnë komunitetit shqiptarë, ndoshta nuk është e tepërt me thonë njëri i Kamenicës më kujtohet mbiemri Rrudhani tha unë tha për herë të parë po me jepet mundësia me hy në Kuvendin e Kosovës edhe pranova dhe kamë pranuar me qenë në listën e astij subjekti politikë, mirpo, meqë koalicioni kur i ka dorëzuar dokumentacionin e aplikacionit e ka nënvizuar e ka bërë një tëk që garon për vendet e garantuara atëherë ne i kemi thënë edhe kryetarëve që edhe këta kandidatë ose këta ne listë të kandidatëve që i keni shqipëtarë a zënë vendin e komunitetit tuaj dhe nuk është në interes të komunitetit tuaj edhe u nënshkrua ajo listë dhe zyra e ka marr si të kryer edhe ka rekomanduar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që ti certifikoj 20 kandidatë prej 30, ndërsa 10 rekomandojnë dhe prap zyra mbetet që 10 kandidatë të cilët janë deklaruar që 4 prej AVC-së dhe 6 prej vetë atyre kandidatëve që të mos çertifikohen. Kjo edhe për arsye se çdo vendim sigurisht do ta cenonte edhe do ta rrezikonte procesin zgjedhor, afatet janë të shkurtuara ky është rekomandimi i KQZ-së, rekomandimi i zyrës juaj mbetet të vendosni.

Valdete Daka: Faleminderit drejtoreshë. A ka dikush ndonjë pyetje?

Betim Gjoshi: Shiko ne me të vërtete që po punojmë në afatet 30 ditorë e kuptojë që njerëzit mund të kenë stres e ngarkesë por kemi një mostrajtim të barabartë të të gjitha çështjeve që na vijnë si institucion. E para kur na dërgohet po e zëmë një ankesë apo një kërkesë e një subjekti politikë PDK e marrim me trajtu, ku na bëhet një ankesë e dikujt tjetër nuk e marrim, na me pas si standard të trajtimit të shtresave, me u pas trajtu shkresat e subjekteve përkatse në ditën

që është dorëzuar, që është dorëzuar me 20 maj , d.m.th një ditë pasi që kanapliku për certifikim dhe kemi ardhur deri te kjo situatë, e dyta me komunikim me shkresa në bazë të qëndrimit të Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve se kur nuk ka vendim ka një konkluzion të përgjithshëm ose të shumicës është mirë me vepru në bazë të tij, prapë nuk kishim ardhur deri në këtë situatë , unë e përkrahi rekomandimin e zyrës sepse nuk kemi edhe rrugë tjetër sepse bijmëndryshe me qëndrimet , po unë jam i bindur që na duhet me i nejt tu ju lut zotit ishalla nuk ankrimojnë, se përndryshe nuk kemi krijuar ndonjë situatë të re bazuar në vendimet e fundit të BZAP-it ose nuk janë përfillur procedurat që duhet me përfillë një institucion zyrtar qoftë komunikimi me shtresa, na mundemi me ju ndihmu me fol në telefon mesçaru njerëzve por bazë edhe ata që e sqarojmë është mirë me përdorë shkresa, edhe mbrojtja ti bëhet e duhur institucionit tonësiç duhet, unë do të votojë për këtë rekomandim të sotëm por mirë është që këta 20 kandidatë me emër e mbiemër të certifikohen, edhe këta 10 kandidatë të tjerë nuk certifikohen për këto arsye të cilat janë përmend këtu.

Valdete Daka: Po kishte me qenë mirë që ky rekomandim bile ky arsyetimi të reflekton edhe në arsyetim, të vendimit pra jo vetëm këtu, po Eshref.

Eshref Visha: Unë do të rikthehem në pika të shkurta të arsyesimit të vendimit të ZAPIT dhe me keqardhje theksoj se ZAP thekson se komisioni qëndror i zgjedhjeve respektivisht sekretariati, ZRPP-ja në këtë rast përfaqësi i cili e ka përfaqësuar KQZ-n nuk ka arritur ta argumentoj, veprimet e ndërmarra administrative të ndërmara me rastin konkretë, madje me asnjë provë materiale të vetme apo me ndonjë mënyrë shkencore, nuk ka arritur ta dëshmojë Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, komisionit i ka munguar madje edhe provat e përpjektëve të komunikimit për rastin konkret ne jemi dëshmitar të asaj dite se komunikimi ka ndodhë , ne i kemi parë zyrtarë të partive këtu mirponë momentin e nënshkrimit , nuk është nxjerr së paku një provë formale që me e mborjt vendimin e komisionit zgjedhor pranë ZAPIT, nëse ato tërhiqen le të bëhet një shkresë, dhe le të nënshkruajn dhe ti tërheqin kandidatët e tyre, kjo është kërkim nga ZAP. Nuk është argumentuar asnjëherë mendoj që të jemi të kujdeshëm në arsyetimin e këti vendimit për arsye se mundë të kthehet i njëjti prap edhe një here, nëse eventualisht subjekti politik e apelon prapë këtë vendim që ne do ta marremi ne sot.

Valdete Daka: Faliminderit Eshref a ka dikush diçka tjetër me shtu, nëse jo kush është për rekomandimin e zyrës ajo është që të certifikohet, ne fakt edhe një here të certifikohen listat e 20 kandidatëve, ndërsa lista prej 10 kandidatëve që të mos certifikohen kush është për, kush është kundër, kush apsteon. Faleminderit.

Betim Gjoshi: Kryetare, edhe një diçka e kam kështu procedurale rreth vendimit të kësaj pune, a na prishë proceduralisht neve punë. Qoftëse ja mundësojm me plotësu ata listën me 10 tjerë në aspektin procedural se ata njëra prej arsyeve që ata kanë thanë, se nuk ja kemi jap mundësin me korigju deri sa nuk i kemi dërgu në prodhim ende broshurat kanë apliku me numër 30 qoftëse komuniteti me numër të njëjtë për me i përmisu mbrenda 24 orëve.

Valdete Daka: Mundemi, vetëm broshurat nëse nuk ka ndonjë efekt.

Adnan Rrustemi: Unë proceduralisht mendoj që gjithçka është dashur të shterohet deri te rekomandimi i zyrës. Kupoj, proceduralisht ne jemi brenda shkeljes, kjo çka po ndodh sot ishte dashur të ndodhte në afatin kur ka qen për plotësim ndryshimin që kemi pasur secili prej nesh, madje një ditë e kemi pasur por me gjith atë dy ditë me plan operacional kur e kemi bërë plotësimet e kemi tërhequr ndonjë kandidat, e kemi prurë ndonjë kandidat por megjithatë deri para këti rekomandimi ka pasur sens me bo komunikimin zyrtar me shkresë. Zyrtar nuk i ka dërguar shkresë të tërheqim këta kandidat a po kupton, për me pas mundësi ata me i plotësu tash ne nuk po i çertifikojmë neve nuk na intereson a kanë ata vullnet ata për 10 kandidat tjerë a jo. Ne thjeshtë në fazën finale, në këtë rast i çertifikuam 20, i deçertifikuam 10 nuk ka asnjë kuptim.

Betim Gjoshi: Unë së pari edhe ky afat mendoj që është për korrigjime, unë mendoj që nuk është për me hëkë e me shtu kandidatë ajo është në qoftëse një kandidat si plotëson ligjet ashtu u`a kthen e mundet brenda afatit ti përmirsoj se për ndryshe ne i hekim si rezultat i pazareve të jemi të qartë, kësaj here jo po herëve tjera ne e dijmë qfar ndodh kandidati për kryetar komune është ndërruar.

Këshilli miratoi këtë pikë të rendit të ditës.

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
